

Kenkat
& A k o l u t h i t
e K r i s h t l i n d i e s

Hora e t'Arbëreshëvet 1977

KUR TE JETA IN'ZOT U LE
 dimbër ish'me borë e shi,
 kjielli e toka bën haré,
 sosi nata e dita u gdhi.
 Zuri fih një kohë e re,
 zu një t'jatérë mbretéri.
 E se u mbush e larta be,
 Shejtit Zef pér martiri,
 Zoti u duk në tri llojé,
 dialë , plak e trim i ri.

Mirë se jerdhe Ti ndër ne,
 o i Pasosmi Perëndì;
 u me glunjëzit ndë dhe ,
 Të lëvdonj ashtu' si di :
 se i vërteti Zot Ti je,
 çë na pate lipisi.

Pér të dashur kjiellin le ,
 deshe t'bëneshe njeri
 se të ndridhurë na pe, ~~me~~
 ndë të kekje zotëri.

Patshe nder ashtu' si e ke ,
 pér gjithëmonë , o shën Mëri ,
 pér tē sterksurit çë dhe ,
 sa tē kishëm na lirë .

Me një fialë çë ti the
 u hap kjielli përsëri .

II

TE KËJO HERË KUSH NGË KLA
 Shën Mërizën ngë e do morë ,
 e pér Zefin mall ngë ka ,
 po dëftonet egërsirë .

Brënda ata ngë i do njeri ,
 bën tëtim edhe bie shi .

U ju lutem pér t'ën'Zonë
 gjithëve sot ashtu' si di :
 tē di shokëvet nj'angonë
 falni ju , te tē vaktat shpi ;
 mos i lëni jashta këta mnorë
 se mbërdhin e reshën borë .

Virgjëresha e mirë ,
 çë ka t'siellënë Zotin Krisht ,
 pëllumbeshën e dëlirë

mirrëni brënda dashurisht ;
 mirrëni Zonjën e shën Mëri
 me kujdes e lipisi .

Plakarushin e bekuar ,
 çë akjë plak e i lodhët ë ,
 mos e leni tē helmuar ,
 se nani ngë ja bën më .

Në tē mirë i bëni sot ,
 ng'e harron i Madh'in'Zot .

Shokë tē lumur' e me nder ,
 teku prëhij ju ngë dini ,
 mos kjëndroni ashtu' tē prerë ;
 në shpit t'ime mënd't'vini .

Shumë tā voglë shpin e kam ,
 posa i vapëkëth u jam .

Eja , o Zonja e sën Mëri ,
 me njeriun kuj kleve e truarë ;
 sillmë Zotin Perëndi ,
 te këjo shpi , tē jet e uruarë .

Ndzitò pran e bënmë hir ,
 këtu' tē lehet Shejti Bir .

PUNË E MADHE Ç'ISHT KËJO!

edhe nata ditë u bë;
u gjézuan gjithë zëmbrat vo;
dimbri shkoi edhe ng'isht më,
e gjithëjeta bën haré:
lule e pemë për në dhe .

Çë shërbes i madhi ki !
ndër 'ta thonë kjielli e dheu;
Zoti i jinë u bë njerì,
nga një mëmë e Virgjérë leu,
te një ftohtë e e vrérët shpellë
prap njeriut t'i japënjë gjellë!

Leu përjashta e jo ndë horë;
leu ndër male e gorromima;
leu nën shiut e leu ndë borë;
lidhur kle me di skutina;
leu ndë kashtë e ndë sanua,
për kë i njohshim ngë u dëftua.

Posa leu tek i vrérëti lekj,
nd'atë vend akjë të shkret,
një këndim nga kjielli u gjekj:

⁷
past lëvdi Zoti i vërtet,
e të mirët posht në dhe
patshin pakje edhe haré.

E gjithë ëngjëjité ndë dritë
mbajën valla (e ç'valla ato),
tue kënduar me një përzitë:
punë e madhe ç'isht këjo,
se i pa-bëmi u njerëzua,
leu tejeta nga një grual

Virgjëresha e shën Mëri,
posa leu i Madh'in'Zot,
e shtrëngoi tek i bardhi gji,
e me sizit t'plot'me lotë,
tha:s'kam t'jetër të t'nikonj ,
po këtë sisë e t'e dhuronj.

Burri i urt i shën Gjusepi,
posa leu Perëndia,
dhezi ziarrmin , e kur shkrepi,
mori e u pruar nga shën Mëria,
e i tha:jipmë një skutinë,
t'ja ngroh , se bëri tsinë.

Deshi Dialin pran më duar;
zu t'i bëj disa haidhi;
 tuke e mbajtur ndë krahuar,
 tuke i puthur ballë e si;
 tuke i thënë : o Zoti i jim,
 u të falem me gëzim.

Vate i pari një delmer,
 për t'i dhënë hern'e mirë
 Zonjës s'madhe , e të bëj nder
 Dialit , ç'ishë si një paskjirë.
 Një karrokje klëmsht i suall,
 e një delezë çë puall.

Hiri nj'etër dalë e dalë,
 edhe tha:një ment e dsura.
 Këto di gjizë valë e valë,
 si më ndodheshin, ju prura.

Pak u bie, ju lip ndëjesë,
 po me zëmërë e me besë.

Vanë t'jerë edhe u harruan;
 hirën brënda e atjó mënuan;
 ran më glunjë e ashtu' kjëndruan

sit e 'tire ng'u mbëshuan,
 posa pan Kë fajin ndsori
 farës t'önë e n'grahë e mori .

Pran një i mjer i vapëk arru';
 the:ngë kisha gjë te shpia;
 veç se këta dhomate dru;
 sa të ngrohet Perëndia;
 edhe prura Zotrës s'aj
 këto di matulla mëraj .

IV

Zonja e jime , mirë ditë!
 Drut u prura , të dhrosisësh
 këtë Dialë si një dritë.
 Mirri,o Zonjë,e shih t'i sglidhësh.
 Fletë të paka e ato t'ullishte;
 degë të trasha,e pak limishte.

Zonja e Madhe , e Lumia Zonjë;
 Çë na solle këtë vo dritë.
 U lash pëthkun çë dërtonj,

kur pash natë se u bë dritë.
 Prua pak për Zonë e math,
 katrë gjizë e tsa diath.

Zonja shejte e Virgjëreshë,
 u bënji bukëzën te mali.
 Dsa të hash, o Perëndeshë,
 Tinë e dhëndërri edhe Diali;
 Të ju bija u t'jatër s'pash
 se një pite e një kulaç.

Zonja Virgjér'gjith'e mirë,
 u , me mall, i bie këtë ftukjë
 Dialit t'bukur si paskjirë.
 Helm më vien se s'kam një puljë.
 S'mënt t'i bënji më t'jatër ndër;
 jam i vapëk e i ngrat delmer.

Gruaza shejte edhe e dëlirë,
 çë parrais isht ki Dialë!
 Në mos vija s'kishë glirë;

Kleva thirrur u pa fialë;
 se s'mënd t'bija më në dorë,
 lakra prura edhe bukmorë.

Sa të shoh më mirret goja,
 Zonja e jime! Tesh për gjë
 dolla, e u ndodha këtei të shkoja;
 pash Parraisin mbi këtë dhe.
 Dsa çë zuri këjo langore,
 një të bukurë pyliatore.

Erdhi nj'etër hënëtuar,
 çë tek ajo shpellë i ngrisi,
 e kishë një arkëz; në duar;
 Pati besë e proskjinisi,
 e la Dialit me harë,
 dardhë e mollë e miladhë.

Erdhën bashk tre demëtorë,
 me tsa klëmsht e me tsa shtalp.
 Posi u ndodheshën në dorë;

prun e mjalt , e miell , e gjalp;
 ja dhuruan me dashuri,
 me gëzim e me haidhi.

Beniamini foli e tha:
 bjerni tesh zumarezën,
 përse dua të frinj ditsa,
 mirë e njoh u herëzën;
 e pastai u dua t'këndonj
 këtë të nokërr të gëzonj.

E Manassi urdhuroi:
 ets e mirr ato flojerë,
 çë djé tata ne dërgoi;
 shih se janë mb'atë derë.
 Un'i bie , dhe ju këndoni,
 shën Mërizën të gëzoni.

Bënjam gjith'po me një zë
 më të bukurin këndim
 çeliëm gjith'sa t'mundjëm më;

nderiëm Zotin me gëzim ;
 gjith'këndo jëm se te dheu
 Perëndia si foshnjë leu.

Pran e lumja e Shën Mëri
 i tha gjithëve shumë vietë
 save i vanë e i bën haidhi,
 Edhe i taksi me t'vërtetë
 te Parraisi gjith't'i siellë,
 tek ajo e pasosme gjellë.

V

Zonja e lume e Shë Mëri
 u vu dialin të këndoj,
 e i rrëfiej , me lot'në si,
 gjith'ato çë kish'të shkoj;
 e vërrej edhe i gëzonej,
 e me mall gjith'zëmbra i mblonej.

Biri i jim, o zëmbra e jime,
 Dialë i vogël , Zot i math,

në Ti do të flësh një thrime,
u më duar të mbanj di-tsath ;
pran , o bir , kur të kjëllon,
Mëma e jote të këndon.

O ju flamura t't'in'Zoti ,
Ëngjij shejtra , më ças
të gjithë ejani këtu' sot,
sa të bëni lodrë e gas.
Të këndojet isht këjo herë
se Isuthi do t'na flerë.

Bir i dashur , çë së janë,
dërgon Ëngjëjit jit at,
për lëvdi,çë t'jerë s'kanë,
të t'këndojet ditë e natë.
Shoh se sythi të shkëlkjoset,
ndienj se zëmbra mua më ljoset.

O Jesu' , famazmë je !
U kurrus e Larta Fialë.

Tij, çë bëre kjiell e dhe,
shoh njeri e të njoh dialë;
Të marr n'grahe e t'përgëzonj,
Të jap sisë e të këndonj.

Ndejmë duarzit, gjella e jime ,
tek i përvëluami gjë;
shih nani të flësh një thrime
këtu' n'grah', se shtrat ngë di.
Të t'këndonj u dua vo shumë ,
njera çë të t'vu ndë gjumë.

Eja,gjum,edhe kjëllé
Birin t'im e të t'in'Zot;
më të shëmbet ti mos le;
se ka derdhur shumë lot;
shumë ai të flërë do ,
eja , gjum e m'e kjëllò.

Ajo buzëzë , kur kjesh
një parrais shkëndin në dhe ;

gjith gëzonet kush të sheh.
 Ai syth , po kur vërrren,
 bën e t' do gjith-kush pa hir,
 flëj , o i vogëlith im bir.

Biri i jim , t'ët at pérés,
 gjith'të mirat të të bierë;
 u të sgjonj e të thérres,
 kur t'ë shoh se hin në derë.
 Ti i gjith' jetës je Sotir;
 flëjëmë,dhëndërr , at e bir .

O Ti i Larti Perëndì,
 Krishti i jim i bukurith,
 s'deshe kjosmë e vapkëzì
 sglodhe tinë, i urti gjith.
 Flëj o Bir,se Të këndonj;
 kur të vinjë jit'at , të sgjonj.

Një këmishëzë u tö gjeta,
 e dua vet të t'ë kjëndis ,
 të t'ë sos si e zurijeta
 flëjëmë , o Bir , se të lipis,
 në të thom sa ke të shkosh,
 e sa ke të më helmosh.

Dua të shkruanj te këjo kjëndimë
 kopshtin ku të dërsish gjak;
 dua të shkruanj të vrërtën vimë
 çë të jep glëmba,shkkelbe e shplakë
 krikje,gozhda e lënkjësi...
 prëju,Bir,për nani .

Flëjëmë,o Bir,o Biri i jim,
 sa vo mëma të këndon;
 e në Ti më ndien tëtim,
 mëma e jote të pështron,
 e në gji të mban me-hir.
 Flëj mbi zëmbrën t'ime , o Bir.

O çë krip të pa-rrëfiem
 isht të rrudhur , duket ar.
 duken ijzë të shkëlkjëmë
 siit e t'uzë , o Bir haidhiar.
 Mbyll sit e buzzën oo,
 të tëgëzonet mëma voo!

Kur Ti,zëmbrë , gjin më thithë,
 mua më duket se t'kjëllonj.
 Kloft ashru i bekuarith
 këta vo klëmshtëth çë të rron.
 Flëj , o Bir , se më dhrosis,
 kur të shoh se rrëhalis .

Këjo kalive, o Biri i jim,
 shum'e sbëluarë e e ftohtëz, isht;
 e m'i bën akjë tëtëtim,
 sa na ngjethet edhé mishët.
 T'jetër u të bënj ngë di ;
 kurkullosu në ktë gji.

Pa - pa dorëzën të t'e ha !...
 shumëth akulli t' e zu.
 Tata jit nani vien pra,
 të na biernjë zjarm e dru,
 të më ngroheh një thërrime,
 flëj , o Bir , ó gjella e jime.

W I

Shën Mëria, tue kënduar,
 merr të Birin e e kjëllon;
 e m'i thot mbë të djepuar:
 flëj , o Bir , edhe bën on.

Flëj , o i Dashur , e mos klaj,
 rri ndë prëhërt ; mos bën vaj.

Oh sa i bukur Ti më je;
 oh sa i hjëleshëm ,Biri i jim!
 siri i jit më jep haré;
 më mbëlon shpirtin me gëzim.

Dialë i vogël , Zot i mathë,
më çë t'shoh , më fort të dua;
rri te gjiri i jim ditsath,
mos shamtij , në më do mua.

Perëndì e njeri i vërtet,
për të marrurin fajtuar
deshe t'vije te këjo jetë,
ku do t'jesh akjë i helmuar.

Biri i jim , i larti Bir,
nanì flëjömë pa mendim;
mëmës t'ende bën këtë hir,
se më pran s'do t'kem gëzim.

Oh sa helme do t'duronj
Sa lavomë te ki gji !
Thom se ahierna s'mënd't'rronj ,
kur të t'shoh te ato hjidhi.

Nga gjithë shokët ka t'jesh lënë,
nga të gjithë a djelm,a plek;

shitur ; puthur edhe zënë
Ti do t'jesh nga Gjudha i kekjë.

Biri i jim,sa do t'më vuash,
për të madhin mall çë ke !
Po me gjakun t'ënt do t'shkruash
se ndëjésën prure në dhe .

Pa mos klaj , o Biri i jim;
Mëma e jote të përgëzon.
Flëj nanì pa psherëtim;
flëj , o Bir , edhe bën on .

Flëj , o i Dashur , ...

Kur Shën Mëria
 tek e ftohta shpellë,
 ndë natë të thellë;
 Jesuin na dha;

Me shejtet duar,
 mbë krahë e(mori) muar,
 e përgëzoi
 edhe e këndoi;

Të lut , o Bir ,
 me dashuri;
 si Perëndì,
 i jetës zot.

Çë të math' shérbes
 shoh e kam besë !
 Atë çë më bëri
 U bëra sot.

23

Kush mënd't'e thoshëj !
 Kje Faremiri,
 i pa-kufiri
 te djeba rri,

Si i vogël dialë,
 çë ngë ka fialë;
 si edhé një i vapëkth,
 një Perëndì !

U thom ndë vetëhë:
 çë të math këshill
 Ti pate , o Bir ,
 t'vije këtu' !

Sa një njeri
 t'ishë Perëndì,
 Ti leve e u bëre
 Dialëth kështu' .

Thuajmë përsé,
 e Larta Fialë,
 si i vogël dialë,
 po kla e rënkòn?

Këta rënkimë ,
o gjella jime,
janë si gozhdë
çë më shajton.

Oh çë famasmë !
s'ësht për të thënë
këjo e madhe punë
çë bëre Ti ;

Se mishu u veshe
se neve deshe;
gjith'të të duam,
si na do ti .

Andaj përpax
nanë më rri ,
si cilimi
çë ngë ndëlgon .

Bën më të kjeshurë
fakjen , si diell
çë ndrit në kjiell ,
se më gëzon.

I Biri i Adhamit ,
kuj Ti bën nder ,
isht akj'i mjerë ,
sa ngë të do .

Sa më e thërret
mbë ktë hjivur ,
ai zëmbrë-gur
më të thot jo .

Tij të shkarzen
i ziu njeri
për lënësi ,
se ngë kupton .

Si një pa si ,
as njeh , as di
si zëmbrën malli
të përvëlon .

Si Ti prej meje ,
prej Teje u jam,
e çëdò kam
prapö të kthenj .

Nanì pér klëmshtitë
çë goja thithë,
o i miri gjithë ,
në më do mirë ,

Njeriun çë bëre
dhize me besë;
jipi ndëjesë;
kiji mëshirë .

Jesuithi i vogël ,
o Birthi jim ,
dhëndërr e mbret
i shpirtit t'im ,

Të truanj fajtorin;
njeriun të truanj;
ruaje , si ruanj
U Tij nanì.

Gjellë , këjo sisë
isht pak , e pak
të bënët gjak;
po Ti s'vë xe,

Se t'shitet ka,
të derdhet pra ,
nga të bijt e botës
gjith pér në dhe .

Bivor , kjo dorë,
kuj mëma i gëzonet ,
ka të drëptonet ...
gluha s'gudson !

Pér krikje flas
kur duhet gas ,
se drita leu
çë na ndriton .

O shpirt,o i dashur ,
çë jetën solle
nga shkjifi m'dolle
të të shërbenj.

V I I I

Kur dimbri ishë i kekjë edhe më
i vrërët,
u leve , o Zoti i jim, te një ka-
live .

Jo ndër gjinde ,
Ti jerdhe linde,
po ndër kafsha e te një grazhd.

O Perëndi ,
këtë punë e bëre Ti për dashri.

Përse te gjiri i jim ngë deshe
të vije,
me gjithë se e fala Tij me besë
të madhe . ?

Eja u prëj;
tesh eja e flëj
te këjo zëmbrë, si ndë shtrat.

O Ti ç' u dua ;
përsé t'a-kënda t'rrish mbi tsə
sanua?

O ju të lum' , o ju të lum'
gjith' monë
delmerëzit , çë pat , te nata e
madhe ,
po si dialë
të Lartën Fialë,
më të bukur se një dritë;
e me gëlirë
ndë dhet Parraisin pat te ajo
fitirë.

O vathëzë me fat, ç'i dhe mbi
kashtën
atë çë atij u duh të vapkë djebë!
Mbi Tij èngjij
mbi Tij arkëngjij
fluturuau me kënka e gas.
Ashtu' u nderove
e u bëre ahierna klishë e dheun
gëzove.

Një ditë u vet llojasia
për Tij e thash:përsé,
e Larta Fialë,
përsé, më thuaj, përsé,
o i Madhi Vasilé,
u bëre Dialë ?

I nokërrith u bëre,
sa mënd't'hije shpejt
në ktë gji.

Po zëmbrën në do,
përse t'e narrsh e do
me kusëri.

Të dashur më dëfton,
e prire e më gënjen.

Përsé këto ndrole ?

Në gjit u dorën ndenj,
e zëmbrën ngë gjenj,
se Ti m' e more .

U dua të t'rrëfenj,
të ndihem te jot'ëmë,
me këmbë e duar .

O Zonja e shën Möri,
u zëmbrë s'kam në gji;
jit bir m' e muar.

M' e vodhi e pran e fshehu
te gjiri i 'Tij, e bën
si kur ngë e ka.

U sot do t'bënj mizirë;
pa shih , kërké Ti mirë,
se ngrah' e ka .

Vërrej se zëmbra e jime
të ngar më para s'kishë,
përpisur rrij,
edhe si gur u tha;
në mos ndërruar u ka
në duar të 'Tij.

O i marruri çë jam !
 Si thom se ösht kusar
 i madh'in'Zot ?
 Zëmbrën aì m'e bë,
 andai kusar nuk ë
 në e mori sot .

Atij çë jetën bëri
 nga zëmbrë mirë i nget,
 se i Zoti isht .
 Të loznejë sa do më;
 s'mënd't'bënje t'jatër gjë,
 se i vogël isht.

Po ajo në u tha si guri,
 çë lodhrë Aì do t'bënje
 me gur të gjall ?
 Po pran kujtonj e thom
 se hekurin dhe njom
 njö zjarm i gjall.

Zëmbrën; o Zoti jim ;
 në mos t'e dhënsa u ,
 mirre pa hir ;
 mirre e gjithëmonë mbe ,
 se tij të nget , çë je
 Zot e Sotir .

X

Gjithë ejani gjinde ,
 të lusim këtë dialë;
 pa e sosëmia Fialë
 në jetë u bë mishë.

Thot: po ngrëhij delmerë,
 e kjiellit përzita;
 më e bukurë se dita
 këjo natë u ngris .

O natëza e bardhë,
 çë zëmbrën t'ënë
 gëzon si kle thënë
 nga i lashti Profit.

Një zë nga Parraisi ,
ju shtijti të ngrëhij:
prej shtratit ku prëhij,
pataksij ! , ju tha .

O natë e bekuarë ,
kur Krishti na u le ,
se Virgjérë e re
na solli mbë dritë .

U mbush ajo e taksurë
çë i Larti na bëri ;
i Jessit te druri
tuf' lulesh u rrit .

I Drejti , i Pafajshmi,
çë moti çë shkoi
akjë dishiroi
nga mjegula u zbrit .

Si vesa e priturë ,
si drita nga dielli,
ki i vogël nga kjielli,
na jerdhi , si uratë.

O burrat e mirë ,
përzimet lëreni;
pa shihëni,vërreni
sa e mirë ë köjo natë!

Një zë çë i pëlkjieshëm
t'in'Zoti lëvdì
e pakje e haidhì
të mirëvet i dha .

Të dashurën pakje ;
të taksur' Abramit ,
çë fara e Adhamit
s'priti më kot .

Pa vëhij më glunjë;
te djeba këndoni
të nokërrin ; lëvdoni
të dhimëshmin Zot .

Nga fusha , nga malet ,
 nga bora , nga vapa ,
 mos mbahij aprapa ,
 se t'gjithëve na thërret .

Mos rrini ndér helme ;
 mos kijnì mbëri ;
 se ligjë e lirì
 u dukën në jetë .

X I

Nga kjielli Ti u zdripe ,
 o Mbreti i jinë ,
 e jerdhe te një shpellë
 ndë borë e tsinë .
 O i bekuam , o i lëvduam ,
 të më dridhesh u Të shoh .
 E Larta Fialë ,
 përsé më deshe mirë ,
 u bëre dialë !

I jetës ti je i Zoti ,
 se vet e stise ;
 e t'linda e ziarr të lipsen ,
 e më lipise .
 O i dëlirë , shejti Bir ,
 zieja jote zëmbrën ngat .
 Po mua m'a-kënda ,
 se malli i mathë për njerëzit
 të pru këtu' brënda .

Parraisin ti lëreve ,
 teku trazhgoje ,
 e mbi tsa kashtë u leve ,
 sa të duroje .
 Fort u bindem e të klindem ;
 Po për mua çë bëre Ti ?
 O gjella e jime ,
 përsé , përsé pajt meje ,
 këta durime ?

Po në Ti deshe t'vije
ndë vapkësi;
përçë nanì po shëmbe,
e bën vajti ?

Zot o Zot , o i Madh'in'Zot ,
mirë e shoh e të ndëlganj :
ngë kla se dhëmbe;
po kla pér dashuri,
pér mall ti shëmbe .

Ti njeh të that'si guri
këtë zëmbrë t'ime ;
e do me lotë t'njomet;
me pshërëtime.

Zot e mbret , At i vërtet,
po që son te ngë ësht ashtu';
nanì të dua ;
nanì të dua sa mëndet,
sa Ti do mua .

39

Kur Ti te gjiri i mëmës
duke i kjëlluar ,
ngë flë jo zëmbra e jote ,
se po rri sgjuar.
Çilimi , Perëndi ,
çë mendon pa thuajmë Ti.
Kush mënd't'e dij !
U thom se më përgjegje :
do t'vdes pér tij .

Në Ti mendon të vdeç ,
o Zot pér mua;
kë t'jatër, jashta Teje ,
u kam të dua ?
Virgjëreshë , o Perëndeshë ,
në e dua pak u Birin t'ënt ,
mos kij mëni ,
po duaje Ti si duhet ,
në vet ngë di .

XII

Këndo jëm , këndo jëm
se kjielli u sbëlli ,
gjithë bëjëm haidhì ,
gjithë thomi me gëzim .

Po rrofshit Isui ,
si rrekjë e si Zot ,
po rrofshit Isui
për jetë e pér mot .

O i dashuri Dialë ,
nga kjielli pér ne
Ti sdripe në dhe
ndër borë e tëtim .

O i bukuri Dialë ,
Ti pakjen dhuron ,
Ti zëmbrat na gëzon
se prure shpëtim .

O i vogëli Dialë
i math Perëndì ,
bekò gjithë njeri
edhe shpirtin t'im .

O i hjieshmi Dialë
i Virgjérës Bir ,
Ti sizit na prir ,
o i Hirit burim .

O i prituri Dialë ,
o Zot i vërtet ,
o i ëngjëvet Mbret ,
mirr 'veshë këtë këndim .

XIII

Rregji i jim ,
Iisuthi i jim ,
Dialë i nokërth ,
ndër tëtim
... jerdh' e leve
bër njeri
te një kalive
si mavri .

Flëj,o Bir , e mos klaj
flëj,o zëmbrë e bën on.

Mbi tsa kashtë
te një grasht
Ti je smardhur
skur se jasht :
... lipset ziarri
dçeshur je
e tëtimit
vdes pér ne .

Të përgëzon ,
Të këndon ,
Mëma jote në të kjëllon.
... nga gomari
e nga një kje
me ahtë e frimë
ngroht je .

Mosnjeri
në vapkësi
Tij të njohu - Perëndì .

... vetëm pate
lutie e ndër
ngah i miri delëmér .

Me haré
vuri ré
se nga kjielli
drit ' e re
... streksi natën
e me gjëzim
bukur gjegji
një këndim.

Dhromin zu
e si arru'
tuke u falur
m'glunj'u shtu'
... diath'e gjizë
e di dru ,
Zoti jinë
ai të pru .

Nder , o Zot ,
t'japiëm sot ,
si delmeri .
çë na thot:
... se vërteta
P e r è n d i
e vërteta je njerì .

Flëj,o Bir,e mos klaj,
flëj,o zëmbrë e bën on .

XIV

Flëjëmë bukur,dial'i nokërth,
flëj më duar,rri në gji,
ng'ë pér Tij djebë e stoli ,
çë ndsën jeta e kjellia jep.
As rröpira,as trikjimia
sa t't!trëmben ngë isht dre.
Drita jote kjiell e dhe
gjith'fiellon e bënet shkjec.

Në tē vërren e vrérët kjiellia,
pér mëkatën kështu tē 'ftonet;
mos u trëmp ,se do t'fiellonet,
e pran gëzim tij tē dëfton.
Pisa · e shkretë e bijët e Evës
luft'e kekje do t't'bëjën ,
proskjinit një ditë ka t'mujën
çë pran jeta Tij dhuròn .

Bir i lart tē mëmës s'parë
mos më klaj,mos tē helmonesh,
Perëndia ,shi' , bën tē ftonesh
dial'i vogël , zot i mathë.
Pér në glëmba e nga helme
lule lehet , lule shpresie,
ligjia e gjithëve , lule besie,
ligja e zëmbrës pér luvath.
Siuthi jit një thikëzë ë
çë shpon zëmbrën , pa nga gjë.

O ju dielm,^o ju fëmijë,
 tek in'Zot me gëzim po rrıdhni,
 ju këndime jetsni e sglidhni
 zëmbrön jipëni se Aì e do .
 Kënkle re zëri i t'ëmbël
 ka këndo jëm për gjithëmonë,
 zëmbra e dhezurë për t'ën'Zonë
 jipet gjith'e kurr thot jo.

Lumë fëmija në gas shejt
 lumt'ata çö janë të drekjtë.

XV

O çë natë m'e bukurë se dita
 kle nata kur leve !
 O çë dritë , o çë gëzim,^o çë pakje
 na prure Ti neve !

Ndër hjidhì njerëzia për sa mot,
 për sa vjetë Tij Të priti

e Ti jerdhe ndër ne, shkrepi
 gëzim bashk me illin ç'na ndriti

Flëjëmë, flëjëmë ,
 flëj,^o Bir, e mos klaj,kij durim,
 ziarr ngë kemi e Ti ndien tëtim.

Flëjëmë, flëjëmë ,
 ipna,zot,dhizna Ti te ki gji
 si një ziarr dashuri.

Madhérò shpirti jim e lëvdò
 Perëndin t'Lartën Fialë
 çë për ne në ktë jetë
 mori kurm
 e na leu si një Dialë.

Madhérò shpirti jim Zotin Krisht
 të Madhin Zot njerëzuar
 bën haidhì ti,lëvdì dialit të ler,
 mos u loth tue kënduar

Flëjëmë

XVI

E fiellët isht nata si dita,
nga kjielli na mbolen edhe drita:
të vini , të vini ,ju gjinde të
shihëni
këtë shpellë ku Krishti u te .

Njeri u bë për ne e Larta Fialë,
i nokërëth Ai leu si një Dialë,
i hjieshëm,i bukur e i mirë:
gjith'rridhni , delmerë,të vini
me gjëzim.

Ju bini kambanë,ju bini:
DIN DON (7herë)
e thrini gjith'gjinden tek in'Zot.
ju bini kambanë,ju bini,ju bini:
na leu Shelbuesi sot .

Na jerdhi shpëtimi,na jerdhi,
gjithë hiret mbi jetën i derdhi:
të vini,të vini,ju gjinde,të shihni
ju Rregjin e kjiellit mbi dhe.

Ai pakjen e shpirtit na pruri,
e zëmbrat e thata si guri
i njomi dhe i sgjoi nga gjumi:
gjithë rrodhën me t'math'dishirim.

Këndoni,të krështerë,këndoni,
të pabesmitë po thrini,po thoni:
të vini , të vini,ju gjinde të
shihëni
të Madhin t'en'Zonë ndër ne .

Ju besën te zëmbrat do t'kini,
me shpresë të madhe do t'vini
te gjella,te ngjallia,te e 'fteta
sa t'gjeni t'pabesmin trazhgim .

XVII

Rroft,po rroft rregji ç'u le
Perëndì e rrekjë në pushtét,
ç'si njeri jerdhi në jetë
e u bë i nokërth për ne .

Dashurin, Ti, o Zot, dëftona
 jipëna ndëjésë për ftesat t'ona,
 se Ti vetëm rregji je,
 rroft, po rroft rregji ç'u le.

XVIII

Si gjegjën Engjëjit
 këndimin e shë Mëris
 çë kjëlloj të Birin
 kjëndruan në sbet.

Me zë t'hjynushëm
 Virgjëresha e bukurë
 m'e hjieshme se illi
 po thoshëj kështu':

Moj Bir, moj Zot
 vistar i jim i mathë
 Ti flë, po u josem
 për kakjë bukurì.

Rroft, po rroft i pakjes mbreti
 çë ndër gjinde pështrim ngë gjeti
 po si zogzë pa folé
 te një shpellë ndër t'ftoht' u le.

Rroft, po rroft rregji ç'u le
 rregji i jetës për gjithëmonë
 Zoti i mathë e gjella jonë
 çë shëndetën pru në dhe.

Rroft, po rroft se mblen si diell
 rregji jinë çë vien nga kjielli
 se na duk një dritë e re
 tek ajo natë çë in'Zot u le.

Rroft, po rroft rregji ç'u le
 e hjynushmia e Larta Fialë
 çë për njerëzit u bë dialë
 e pamet na pru haré.

Sgjonet i Dashuri
e gjith'i përmallshëm
me siun e përkdhel
Mëmën e 'Tij.

Lavosur'ë këjo Mëmë
nga ata si t'hjynushmë
ç'i kjeshiën , çé gëzojën.
Çë Mëmë e fatbardhë !

O Zonj'e Parraisit
çë Birin na dhe,
Ti lutu pér ne
t'na ket lipisi .

XIX

Të falem,o i lëvdoshmi mbret i
nokérth!
Kush ashtu! i vapék të bëri
t'jesh?

Ti i t'Lartit i Biri i dashur!.
ndë dhe e i përujur ashtuò, përsé?

Amlia e vetëm t'zëmbrës bukurë
të bëri të lindëshe foshnjë pér
mua.

Kush Tij nga kjiellia të sdripëshe
bëri?
të mirrie të burrit trupin kush
kle?

Të rrëtheshe të vdekjies me të
zezën hjé,
mbret i pandërruashëm, mbret i
pa-vdekshëm!

Të zëmbrës bukurë dëshiri i math
të vdekjies çajti të hollën shpatë,
e zëmbrës bukurë vet dashuria
të bëri të leheshe dialë pér mua.

A D E S T E F I D E L E S

Ejani t  b sm ,  ngj lli na thr t
 jani po  jani Betle m:
se l het p r ne Krishti Shelbues.

Ejani, po  jani adhuroj m , adhuroj m
t' n'Zon  Iisuin .

Drita e j t s shk lkj n te nj  shpell 
besa na kj ll n  Betle m
se l het p r ne Krishti Shelbues.

Ejani , po  jani adhuroj m , adhuroj m
t' n'Zon  Iisuin .

I Biri i Per ndis , Rrogji i gjith sis ,
u b  f mij  ne Betle m,
se l het p r ne Krishti Shelbues .

Ejani , po  jani ...

L vd  n  kjiell , pakj  mbi dhe
Nj   ngj ll lajm ron n  Betle m
se l het p r ne Krishti Shelbues .

Ejani , po  jani ...

P R O F E T S I T
 çë sglidhen ditën më para se
 K R I S H T L I N D I A

+

t e k e p a r a O R È

Ms. II, 7-8. Perëndia më tha mua:
 im Bir je Ti: U sot Tij të leva.

Ti mua lipëmë, e U mam të t'jap
 Tij trazhgim t'ënt gjindet .

piesë nga Profetsìa e Mihjeut

V, 1-3. Këtë tha in'Zot: E ti
 Vithleém, shpi t'Efrathàs, ngë je
 ti , jo , më e vogëla ndër zotë-
 rìt e Judhës, pse ngah ti ka të
 dalnjë Kaptenja çë ka t'kulotë-
 një popullin t'im Israelin.

Të zënít e 'tij çë nga fillimi,
 nga ditët e motçme.

2. Prandai Aì do t'e lënjë njerëzë gruaja me barrë do t'lindënjet e t'jerë vëllézër do t'ipriren te të bijët e Israelit .

3. E do t'rrie i fort e të ruanjë e të kulotënjet me fukjì in'Zot e gjithë do t'jenë te lëvdia e emrit e t'in'Zoti Perëndia i 'tij, përqë ka t'jenë madhëruar njer te kufimet e botës .

t e k e t r e t a O R È

Is.IX,6 . Na leu Diali,Biri e na kle dhënë neve.

Perandoria e 'tij isht mbi krahët e 'tij.

p i e s ë nga profetsia e Baruhut III,36-IV,4.

37. Aì gjeti gjithë udhët e dijturis e ja mësoi Jakobit shërbëtorit t'tij e Israelit të dashurit t'tij.

38. Pas këto u dëftua mbi dhet e rroi bashkë me njerëzit.

1. Ki ë libri i urdhurimevet të Perëndis e Ligja çë nglatet përmot e jetë.

Gjithë ata çë i mbahen fort ka t'rrojën , por ata çë e lën ka të vdesiën.

2. Priru , o Jakob,e mbaje fort; jits ku shkëlqjen drita e 'Tij.

3. Mos jip nj'etri lëvdin t'ënde e atë çë tij t'vlen njëi kombi i huaj.

4. Na jemi të lumë,o Israel,pse atë çë i pëlqjeu t'in'Zoti kle sbëluar neve .

në gji e ka t'i lehet një Bir e ka t'i vën embrin e 'tij EMANUIL, çë këthier vien më rar: PERËNDIA ME NE .

15. Ai ka t'hanjë gjalp e mjajtë njera çë të njohënjë si ka t'jikënëjë të ligën e të sgledhënëjë të mirën.

16. Përçë më para edhé se Diali të njohënjë të mirën e të ligën, ngë arrën e liga të sgledhënëjë të mirën. E më tha in'Zot:

1. Mirrë një libër i mathë e shkruaj me pendë njeriu:bëj me rrëmbim ndarie plaçkash - vëlén - e pér deshmëtarë mirrëmë burra besnikë; Urin priftin e Zaharin të birin e Barahjis.

E vanë te Profetsha e ajo zuri në gji e lindi një Dialë.

E më tha in'Zot:njize plaçkò e ndaj me rrëmbim, pse më para se

tek e gjashtëta ORË

Ms.109,3. Më para se agimi U tē pata nga gjiri i:jim:bëri be in'Zot e ngë dot'pendonet.

Tha in'Zot:t'im Zoti:uju tek e drejta jime njera çë U vë armikjët t'atë nën këmbëvet t'ote.

p i e s ë nga Prof.e Isaïs:

VII,10-16; VIII,1-4,9

- E shtoi tē flisëj in'Zot Ahazit e i tha:

11. Lip pér tij një shenk nga Zoti Perëndia jit;nga tē humbëti-të e prej s'larti.

12. E Ahaz tha:ngë dua t'e lip e ngë dua t'ngas t'ën'Zonë.

13. E tha Isaia: atëherë dëgjò , o shpi e Davidhit, omse ë pak pér ju tē lodhëni durimin e njerëzë-vet ? E nanì do tē lodhëni atë tē Perëndis ?

14. Prandai in'Zot vet ju jep një shenk:shi! Virgjëra ka t'zënëjë në

Diali tē die tē thérresönjë tē
jatin e tē jémén, ka t'marrënjë
fukjin e Damaskut e plaçkat e Sa-
maris pérpara rregjit e Assiria-
nëvet.

In'Zot ë me ne : t'e dini ju ,
o kombe e tē pérujij. Tē gjegjij
tē gjithë njera çë ku sos dheu.

Ju tē pushtetshmë, tē pérujij.

Pse në mirräni prapë fukji, pra-
pë do t'jini pérujur.

E në bëni ndo mendim, in'Zot ju e
prish. E në do t'thoni ndo fialë,
ngë kjëndron ndër jush, pse me ne
isht in' Zot .

tek e nëndëta ORË

Ms. 86. Të Mëmës Šion ka t' thu-
het: gjithë njerëzit len tek ajò
e atë stisi i Larti vet .

themelet e Jerusalimit janë te
malet tē shejtë.

piesë nga profetsia e Isaïs

IX,6-7. Na leu Diali , Biri, e
na kle dhënë neve. Perandoria e
'tij isht mbi krahët e 'tij.

E embri i 'tij ka t' thritet:
Engjëlli i këshillit t'mathë, Kë-
shilltar i famasëshëm, Perëndi i
fort, ip pushtetshëm, Kriatar i pa-
kjes, Ai i jetës s'ardhëshme. Do
t'bie pakje kjiverrtarëvet e shën-
detë atij.

E madhe perandoria e 'tij e t'pa-
kjes s'tij s'ka kufi mbi thronin

e Davidhit e mbi mbretérin e'Tij
sa t'e ndrekjënje e t'i japënje
kjëndresë, çë nanì e pér jetë.

Zeli i Zotit t'ushtrivet ka të
bënje këtò .

Σήμερον γεννᾶται
ἐκ Παρθένου ...

Sot lehet nga Virgjëra Aì çë
mban në pëllëmbë të dorës gji-
thë kriesën.

Me skutina kle pështiellë si
njeri Aì çë në të klënit t'Tij
isht i pa-dukshëm.

Perëndia isht ngulur te një
grazhd , Aì çë kjëndresën i dha
kjielliavet çë moti në të zënit
fill.

Nga sisë ushkjenet me klëmshtë,
Aì çë në shkretirë ujisi popullin
me Mannën .

Magjinjtë thërrét Dhëndërri i
Klishës .

Dhuretit e këtireve merr i Biri
i Virgjëreshës.

Na i falemi të lerit t'at , o
Krisht .

Dëftona të Dukurit t'atë të hju-
nushëm .

TË LERIT I ZOTIT T'ËNË
IISU ' KRISHTIT PERËNDI '

në Mbremësore
te 'Kjirie ekjekraksa':

'Hxoc β'

Ejani të gëzonemi tek in'Zot tue rrëfiejtur këtë mister:Muri i gardhit ra! Shpata e flaktë jep krahët e jik e Hjeruvimtë bien Drurin e gjellës dhe u marr piesë te hareja e Parraisit nga i çili , sa mos t'mirria 'veshë,kleva shtur jashtë.

E pa-ndërruashmia fitirë e Atit shejza e pérjetësis s'Tij,tue marrë trajtën e shërbëtorit,lehet nga Virgjëra Mëmë pa pesuar ndrishim.

Pse Aì çë ishë mbeti,tue klënë Perëndì i vërtét,e mori atë çë ngë ishë tue u bër njeri pér dashuri.

Atij po thérresiäm: o Perëndì i ler nga Virgjëra, kij lipisi pér ne.

Si Zoti Iisu' lehet nga shejta Virgjérë, gjithkjish ndritet. Si delmerët natën ruajën, Magjinjtë përmisen, Engjëjit këndo jën, Ero-dhi tërbonet se Perëndia dëftonet në kurm, Shpëtuesi i shpirtravet t'anë.

Rregjëria jote, o Krisht Perëndì, ë rregjëri të gjithë kohëvet e zotëria jote në çëdò jini pas jinie.

I mishëruar paj të Shpirtit Shejt e bër njeri nga e Povirgjëra e shën Mëri, Dritë shkëlkjeve neve, o Krisht Perëndì me të jardhurit t'at, Dritë nga Drita, të shkëlkjierit e Atit gëzòn gjithë kriesën.

Çëdò frimë të himnòn, shejzë të lëvdis s'Jatit. O Ti çë je, po gjithmonë kle klënë, dhe lambari-se nga Virgjëra paçe lipisi pér ne.

Gë ka t't'faliäm, o Krisht, se jerdhe si njeri pér ne?

Çëdò kriesë ë bër ngah Ti të falnderimin: Engjëjit himnin, kjielliat illin, Magjinjtë dhuretít, delmerët çudhìn, Dheu shpellën, shkretira grazhdin, na Mëmën Virgjörë. O i paramotshmi Perëndì, kijna lipisi.

Δόξα ... nał vūv ...

Si rregjëroj Avgusti mbi Dheun, shumëparësia e njerëzëvet kishë pushuar. Si Ti u mishërove prej të Dëllirës, lutësia e idhujvet u prish.

Përposh njëi mbretërie botnore kijitetet u shtruan. Te një e vetme zotëri të Perëndis kombet besuan.

U shkruan popujit pér urdhurin e Kjesarit; U shkruan të besmitë te embri i Perëndis, si Ti Perëndiajini u bëre njeri.

E · madhe ë lipisia jote , o i Ma-
dh'in'Zot . Paçe lëvdi !

P r o f e t s i t

e Tropariet

I Nga tē Bërit I,1-13

Në tē zénit fill Perëndia bëri
kjelliën e dheun .

2. E dheu ishë i pa-tëdukur e i
pa-gjë fare e tē errëtitë ishë
mbi fakjen e honit e Shpirti i
Perëndis sillej mbi ujërat.

3. E Perëndia tha : u bëft drita
e drita u bë .

4. E Perëndia pa se drita ishë e
mirë, e ndajti dritën nga tē er-
rëtitë.

5. E dritën e thriti d i t ë e
tē errëtitë n a t ë .

E mbrëmie e menatë u bë dita e
parë.

6. E Përëndia tha: u bëft një tē
ndejtur në mes tē ujëravet e kloft
këta në mes çë ndan ujë nga ujë.

E kështu' u bë.

7. E Perëndia bëri tē ndejturit
e ndajti në mes ujërat çë janë si-
për tē ndejturit.

8. E Perëndia këta tē ndejtur e
thërriti k j i e l l . E pa Perën-
dia se ishë mirë. E mbrëmie e me-
natë u bë dita e dijtë.

9. E Perëndia tha: le t'mbëjidhen
ujërat çë janë përposh kjielliës
mbë një vend bashkë e le t'dukën
tē termittë. E u bë kështu'. E ujë-
rat çë ishën përposh kjielliës u
mbëjodhën bashkë te vendet e 'ti-
re e u duk tē termittë.

E Perëndia tē termittë e thërriti
d h e e tē mbëjedhurat e ujëravet

e thërriti d e j t . E pa Perën-dia se ishë mirë .

11. E Perëndia tha : le t'shtienjë dheu bar të njomë, bar çë bën farë e dru pemie çë bën pemë: llojét, nga-një t'i glasënëjë farës s'tij e të jet tek ai fara e 'tij te llo-jeja e 'tij mbi dhet. E ubë kësh-tu'.

12. E dheu shtu e dha bar të njo-më, bar çë bën farë mbë llojét gjah fara e 'tij ndë 'të mbë llojét e 'tire mbi dhet. E Perëndia pa se ishë mirë .

13. E mbrëmje e menatë ubë e tre-ta ditë.

Λαθὼν ἐτέχθης ... Ἡχ.πλ.β:

Fshehurith Ti leve brënda njëi shpellie; po kjielli gjithëve të ligjëroi tue perdonur një ill,
o Shpëtues!

E Magjinjtë Ti prure sa të të përmiseshën me besë; me të çilit Ti kijnna lipisi.

Ms.86,2. Themelet e Jerusalimit janë të malet t'shejtë. T'in'Zoti i pëlkiejën diert e Sionit më shumë se gjithë tendat e Jakobit.

Lëvdì u kanë thënë mbi tij, o kjitet i Perëndis. Ndër ata çë më njobhiën do t'ku tonj Raabin e Babilonën.

Filistenjtë e Tirët e populli i Etiopëvet janë kjitetësë t'atë .

Të Mëmës Sion ka t' thuhet:
gjithë njerëzitë len tek Ajò
e Atë e stisi i Larti vet.

In'Zot do t'shkruanjë te tö
shkruamet e popujvet:këta lenë
brënda Sionit . E gjithë ata çë
jesiën tek Ajo janë të gëzuamë.

II. nga prof. e Isaïs IX,6-7.

vérrej f. 61.

'Avéteiλας Χριστέ,...

U leve , o Krisht , nga Virgjë-
ra, Diell i mendshëm i drejtësis
e illi të dëftoi Tij të papörm-
bajturshëm i mbajtur në një sh-
pellë.

Udhëhekjë Magjinjtë të të pro-
skjinisiën; me ata edhe na të
madhérojëm , o gjellëdhënës ,
paçë lëvdì !

Perëndia rregjëron; u pështrua me
madhëri , u rrethua me fukji.

E kështu' dheut i dha kjëndresë
e s'do t'tundet. Gati ë throni jit
çë ahierna .

Ngrëjtën lumet,o i Madh'in'Zot,
ngrëjtën lumet zëret e 'tire,me
zëra shumë ujérash.

Të famasëshme suvalat e dejtit ,
po sa më i famasëshëm in'Zot te
të lartitë kjiej. Deshmimet t'atë
janë shumë të besmë.

Shpis s'ate i përket shejtëria,
o Perëndi , për ditë të glata .

nga Prof. e Isaïs
VII,10-16;VIII,1,4,9,10,16.

vérrej f. 58 .

Më para se agimi U tē pata nga gjiri i jim. Béri be in'Zot e ngë do t'pendonet.

γ' Si leu Zoti Krisht nē Vithleém tē Judhés, tē jardhurë nga lindia Magjinjtë u përmisën Perëndis bér njerì me-hir^e tue sbillur thesaret e 'tire i falën Atij dhureti tē çmuame: ar i pastër si Mbretit i jetëvet, livanin si Perëndis i gjithëve, e mirrën tē pavdekshmit i vdekur pér tri ditë. O ju kombe tē gjithë, ejani t'i përmisij Atij çë leu sa t'shpëtoj shpirrat t'anë.

Δόξα... δ' Gëzou, o Jerusalim, bëni haithi ju gjithë çë doni Sionin. Sot u sglith lidhia e motçme e nëmës e Adhamit; parraisi na u sbill, gjalpëri kle shtipur, kur pa gruan çë Aì kishë gënjer nani tē bënet Mëmë e Krionjësit.

A p o s t i h a

^{χ. β'} Një mister i mathë e i famasëshëm mbaronet sot. Një Virgjërë lind e virgjëria ngë pri-shet. Fiala merr mishë e nga Perëndia ngë ndahet. Engjëjitë me delmerët lëvdojën e na me ata po thërresiën : lëvdì Perëndis te më i larti kjieh e pakje mbi dhe .

ms.109,1. Tha Zoti t'im'Zoti:ju tek e drejta jime njera çë u vë armikjët t'atë nën këmbëvet t'ote.

^{χ. γ'} Sot Virgjëra lin Bëresin e gjithësis. Edhem i fal shpellën e ylli lajmëron Krishtin, Dielin te tē errëtitë. Magjinjtë u përujën tue falur dhureti tē ndriturë nga besa. Delmerët pan famasmën si Engjëjitë këndojojn: Lëvdì te m'i larti kjiell.

Sa tē humbët pasuria , dieja,
tē njohurit e Perëndis !

Ajo çë kle vegle mëkatie e pru
mortien gjithë njeriu sot u bë
fillimi i sheëndetës jetës s'të-
rë paj tē Mëmës s'tin'Zoti: paj
t'Saj i përsosuri Perëndi u bë
fëmijë tue ler pa çajtur vulën
e virgjérìs. Me skutinat ajo
sglidhi hekuret e mëkatëvet t'
t'ona ;me tē lerit si një foshnjë
shëndoshi dhëmbiet e idhnimet e
Evës. Andai gjithë kriesa le tē
bënë haré, se Krishti jerdhi sa
tē përtërij e shpëtoj shpirrat
t'anë.

O Krisht Perëndi, Ti mbe-
te te një shpellë e tē priti grazh-
di. Delmerë e Magjinjë t'u përmis-
sën . Ahierna u mbarua ligjërimi

i Profet travet e fukjìt e Ëngjëj-
vet u famasën e thërrisiën tue
thönë: lëvdì tē tē jardhurit t'at,
o i vetëmi Njeridashës !

A p o l i t i k j i i

Të Lerit t'at, o Krisht Perëndia
jinë, jerdhi e shkrepi në jetë dri-
tën e dijturis; se për atë proskji-
nitarët e ijëzëvet nga një ill
klenë mësuar t'i përmiseshën Tij
Dielli i drejtësis e t't' njihiën
s'larti si Lindie, o Zot, lëvdì Tij!

I jenisis su Hristé o Theòs imòn
anëtile to kosmo to fos to tis
gnoseos, en aftì gar i tis astris
latrevondes, ipo astéros edhidhas-
kondo se proskjnìn ton Ilion tis
dhikjeosinis kje se jinoskjin eks
ipsus anatolin , Kjirie dhoksa
si !

në Mëngjes

Δεῦτε Ἰδωμεν ...

Ejani shohiën tē besmë ° teku
na u le Krishti; ° jetsiën e ve-
mi pra ° teku vete illi ,° bashkë
me Magjinjtë tē Lindies -°rregjéra
Engjëjitë këndojën ° pa tē sosur
atjé .° Delmerët pérjashta ° kënkën
e bukurë ° lëvdi në tē lartit
këndojën°, Atij çë sot ° te një
shpellë u le,°nga Virgjëresha °
e Möma e Perëndis, në Betlem tē
Judhés.

Ti Θαυμάζεις, Μαρία ;

Pérçë famase , o Mariam ?
pse çudhite mbi çë streks tek Ti ?
Një Bir i pérhershëm ° në kohë
U linda , thot ajo .

Virgjérë U jam + e si lind U
një Bir °? Kush ka kurr par një
lindie virgjërore ? ° Po kur do
in'Zot ° rregullimi i naturës
mundet , si ë shkruar .

Krishti u le ; nga Virgjëresha°
në Vithleém të Judhés .

Ms. 135 (Polielei)

Lartësoni t'en'Zonë se isht i
mirë , se e pasosme lipisia e
'Tij.

Lartësoni Perëndin e Perëndivet..

Lartësoni Zotin e zotravet ...

Atë çë bën famasmë të mëdha i
vetëm ...

Atë çë bëri kjielliat me men-
die ...

Atë çë shtroi dheun mbi ujërat ...

Atë çë bëri drizatit e mëdhe-
një i vetëm

Atë çë bëri diellintë zotëroj di-
tën ...

Atë çë bëri hënzën e ijëzit të
zotërojën natën ...

Atë çë rrahu Egjiptin me të pa-
linduritë e 'tire ...

Atë çë ndsori Israelin ndër mes
t'atireve

me dorë të fortë e krah të glat ...

Atë Atë çë ndajti dejtin e kukjë
ndish ...

Atë çë bëri të shkoj Israeli ndër
mes t'atij ...

Atë çë shturi Faraonin e ushtrin
e 'tij te dejti i kukjë ...

Atë çë kjelli popullin e'tij
për në shkretirë ...

Atë çë mundi rregjëra të mëdhenjë ...

Atë çë vrau rregjëra të fortë ...

Siònin rregjin e amorenjëvet ...

E Ogìn rregjin e Basanit ...

E çë dha dheun ~~gatjreve~~ për trazhgim ...

TRAZHGIM ISRAELIT POPULLIT E 'TIJ ...

Se u kujtua për ne te mjerësia jonë in'Zot ...

E liroi neve nga armikjët t'anë ...

Aì çë jep të ngrënë gjithë njëriu ...

Lartësoni Perëndì e kjielliavet, se e pasosme isht lipisia e 'Tij, a l i l u j a .

'O ἀχώρητος παντί ...

I pa-ndsënëshmi gjithëkund° si ë ndsënë në gji ? ° Aì çë rri n'gji t'Atit , si ndodhet nani ngrahë së jëmës ? ° Kle si Aì tha ° si deshi si i pëlkjeu. Posa mishë s'kishë° deshi t'e mirrëj °. Aì i çili isht për ne u bë atë çë ng'ishë° e pa dalë nga natura e 'tij ° edhé t'ë-nën mori . Krishti ka një të ler difish° Aì çë vien të mbushën jetën s'larti .

pas Vangjejit (Mt. 1,18-25)
veni të puthiën librin e V. tue
thënë ms. 50.

Lëvdì past...

⁷Hx. β'

Sot gjithkjish mbushe me ha-
ré pse Krishti leu nga Virgjë-
ra.

nanì e ...

Sot

⁷Hx. πβΔδξα ἐν ὑφεστοις ...

Lëvdì Perëndis te më i larti kji-
ell. Sot Vithléémi pret At çë rri
gjithëmonë me t'Jatin.

Sot Ëngjëjit Dialit të ler i ja-
piën lëvdì si i nget Perëndis.

Lëvdì te më i larti kjiell Pe-
rëndis , pakje mbi dhe , mirëda-
shie ndër njerëzitë .

K a n o n i

ODHA E PARË

Shi' lehet Krishti,lëvdonie
shi' vien nga kjiellia ju t'e pri-
tëni.

Shi' Krishti mbi dhet: ju ngrëhu-
ni. Zotit po t'i këndonijeta e
gjithë, edhe ndë: gëzime,zëni kën-
ka, popuj,ju, se u lëvdërua Aì .

Atij çë bër pas fitirës s'Perëndis
për ftesën kishë rar nga lartësi-
rat e gjellës s'hjynushme e u kishë
bër robë të prishëris i dijshmi K
Krionjës përsëri i jep trajten të
përparshmen , pse u lëvdërua Aì .

Si sheh njeriun , veprë e duarë-
vet t'Tij, se isht e sbiret, uj kji-
elliat e i sdripet e te gjiri i
të dëlirës e hjynushme Virgjërë,
tue marrë vërteta mishë, tërë bë-
net njeri i përsosur , pse u lëv-
dërua Aì .

Tue klënë Bir i Atit, të shkëlkji-
erit e 'Tij, Dieja , Fiala , Fukjia,
Krishti Perëndia jinë luajti fu-
kjit te jetshme e mbi-jetshme
e tue u bër njeri, na zaptoi , pse
u lëvdërua Aì.

2. Popullin shpëtoi °tue bër fa-
mamë Zoti ° kur vala e dejtit °
thajti te kjëmoti.

Nga një vajzë virgjërë °ashtu'
si deshi leu ° dhromin e kjiellit °

sbilli neve e na shpérbleu °gji-
thönjëi klënie me Atin ° na nje-
rézit lëvdomie .

I përfitiruar bukur te driza e
paprishëshme nga ziarri, pruri gji-
ri i shejtëruam Fialën Perëndi
çë mori trajten njerëzore të mje-
rin gji të Evës nga nëma e mot-
çme dhe e frangosme sa t'liroj:
na njerëzitë e lëvdojëm .

Dëftoi illi-ç'ë më par'se diel-
li- Kë vij të prishëj mëkatën.
Magjinjëvet si i vapëk te një
shpellë, çë vuaj me ne i pështié-
llë te skutinat. Ata u gëzuan si
Të njojen si njeri e Perëndi.

ODHA E TRETE

Birit çë më para se jetët pa u pakësuar lehet nga i Jati e çë nani ,pa e prishur , merr mishë nga Virgjëra ,Krishtit Perëndi,na po thërresiën : o Ti çë neve na lartëson ,sa je i Shejt , o i Madh' in'Zot !

Adhami i dheshëm kishë trazhgu- ar një të frimëzuar më të lart,po paj të gënjinimit t'gruas kishë rارت te prishia. Si prej s'largu të pa, o Krisht,Bir gruaje,zu të të thërrisëj : O Ti çë pér mua u bëre si u ,sa je i Shejt,o i Madh'inë Zot !

Ti, o Krisht , çë nani mblesi bër njëi kurmi botie pa çmim tue marrë këta mishë fajtorë e vure te ana e naturës t'ënde e h gjynushme. Tue ler si njeri e mbetur Perëndi na lartësove neve çë

të këndo jëm:sa je i Shejt, o i Madh'in'Zot !

Gëzou,o Vithleém:, mbret i kjitetëvet të Judhës,pse Delmeri çë kultot Israelin e ë kjellur mbi krahet e Hjeruvimëvet , vien ngah Ti pérpara gjithëve e tue na lartësuar rregjeron mbi gjithë ne .

2. Pranò këndimet e shërbëtorëvet t'atë tue përujur të armikut të lartësuamen kreni. O i Lum çë gjithkjish sheh,ruaji nga mëkata melodhët t'atë çë kjëndrojën të pashkundshmë themeluarë mbi Besën.

U çmendën pérpara pamies të pazar konshme delmerët çë ruajën pérjashta e klenë bër të mirë të shihien të lindurit të lum të nuses e dëlirë e ushtrin e kjielliavet çë këndo jën Krishtin rrekjë i lindur nga Virgjëra.

Diali tē die tē thérresënjë tē
jatin e tē jämén, ka t'marrënjë
fukjin e Damaskut e plaçkat e Sa-
maris pérpara rregjit e Assiria-
nëvet.

In'Zot ë me ne : t'e dini ju ,
o kombe e tē pérupij. Tē gjegjij
tē gjithë njera çë ku sos dheu.

Ju tē pushtetshmë, tē pérupij.

Pse në mirrëni prapë fukji, pra-
pë do t'jini pérupjur.

E në bëni ndo mendim, in'Zot ju e
prish. E në do t'thoni ndo fialë,
ngë kjëndron ndër jush, pse me
isht in' Zot .

tek e nëndëta ORË

Ms. 86. Të Mëmës Šion ka t' thu-
het:gjithë njerëzit len tek ajò
e atë stisi i Larti vet .

themelet e Jerusalimit janë te
malet tē shejtë.

piesë nga profetsia e Isaïs

IX,6-7. Na leu Diali , Biri, e
na kle dhënë neve. Perandoria e
'tij isht mbi krahët e 'tij.

E embri i 'tij ka t' thritet:
Engjëlli i këshillit t'mathë, Kë-
shilltar i famasëshëm, Perëndì i
fort, ip pushtetshëm, Kriatar i pa-
kjes, Ai i jetës s'ardhëshme. Do
t'bie pakje kjiverrtarëvet e shën-
detë atij.

E madhe perandoria e 'tij e t'pa-
kjes s'tij s'ka kufi mbi thronin

kat e Samaris tue prierrë gënji-min në besë e pëlkieme Perëndis.

Lëvdì fukjis t'ënde , o i Madhi in'Zot !

Mbushe me haré të dishmitë sht-éllësë e të motçmit shortar Bala-am,të nisurit t'misterövet,stu-dhionjësitë e ijzëvet e i prite mirë si të parët e kombëvet kur jerdhën e të falën dhureti të vë-jéfshme , o Zoti Krisht çë u ngrë-jte si ill i Jakobit .

Si shiu mbi bashkën u sdripe,
o Krisht,në gjirin virgjëror,
si pikët çë bien një e një mbi dhet.

Ethiopët , e banorët e Tarsit;
ishujitë e Arabëvet,Saba të Me-dhëvet,të parët e gjithë botës

t'u përmisën,o Shpëtues. Lëvdì fu-kjis t'ënde , o i Madh'in'Zot.

2. Profeti i motçëm Avakum para-lajnëroi një jini e re njerëzish, posa kle bër i mirë t'i vegoj fitirën me një viershë i pathënëshëm.

Pse Diali i vogël çë vien nga mali çë ë Virgjëra , isht FIA-LA çë vien të përtërinjë popujit.

Ti deshe të vije tek na , i një-jtë me njerëzitë tue marrë mishët nga një Virgjërë , Ti çë je i Lar-ti Perëndì,sa t'prishie helmin e o kries t'gjalpërit tue na kjel-lur gjithë nga diert pa diella te lambarit gjallsore.

O kombe më para thellë në prishë
rì, çë jikët nga një pri hie e

krejtë t'armikut , ngrëni e kësi-
ni duart tue kënduar e tue pro-
skjinisur vetëm Krishtin, mirë-
bëresin çë jerdhi ne mes 'neve,
pse na do mirë .

Tue ler , o Virgjérë, nga rrrenja
e Jesseut , Ti i shkove kufimet e
naturës njerëzore tue lindur të
para jetëvet Fialën e Atit , , pse
deshi Ati të dilëj nga gjiri i
jit , tue e lënë i vulosur. Oh çë
të u përunjur t'pallojasëshëm !

ODHA E PESTË

Tue klënë Perëndì pakjie e At i
lipisivet, dërgove neve ëngjëllin
të të madhit Këshill sa t'na bij
pakjen: kështu' udhëhekjurë ndaj
dritës të të njohurit të hjynu-
shëm, çë nga nata prierrë tek Ti
të lëvdojëm , o njeidashës .

Tue u shkruar, si more'veshë
urdhurimin, ndër shërbëtorët e
Kjesarit, na lirove , o Krisht,
neve shërbëtorë të armikut e të
mëkatës. Tue u vapkësuar i tërë
për ne, Ti me këtë bashkim e kun-
gim hjynova Botën t'ënë.

Shi' se Virgjëresha , si u tha
çë moti, zuri në gji e pruri në
jetë një Perëndì bër njeri e
kjëndroi virgjérë. . Paj t'saj

pakjétuarë me Perëndin na fajtorë e këndojojmë me besë si me të drejt Möma e t'in'Zoti.

2. Neve çë nga veprat e natës, nga një gënjam i errët sgjonemi sa t't'këndojojmë himnin çë i nget Mirëbëresit, eja o Krisht e bier-na shpërblimin e një dhrom i leh-të, të shkuar të çilin, t'arrëjëm te lëvdia .

Posa me të jardhurit në mishë mënd'e sosi armikjësia e ashprë kundra Atij vet, in'Zot prishi fukjin e nëndheshmit vrasës të shpirtravet e bashkoi Botën me klëniet shpirtullore e sbutsoi Krionjësin ndaj kriesës.

Populli më para më t'errët pa te këjo ditë dritë si flaka ziar-ri në kjiell. Biri fal t'Jatit Pe-

rëndi kombet si trazhgim, të pa-thënëshmen Dhuratë tue dhuruar, ku më para më shumë kishë lulëzuar mëkata.

ODHA E GJASHTËTË

Nga gjiri Jonën si embrion kafsha e dejtit e ndsori si e kishë marrë. Fiala çë në gji të Virgjë-rës rrijti e mori mishë dolli tue e ruajtur e pa-prishur. Ngë duroi prishien e virgjëris t'Asaj çë e lindi dhe e mbajti pa dëm.

Erdhi si njeri Krishti Perëndia jinë të çilin Ati lind në gji më para se illi i menatës.

Ai çë mban freret e fukjivet të pastra, ë vënë te grazhdi i sh-tazavet e pështiellë me zhele, po Ai sglith vargjet të ngatrruuamë të mëkatëvet.

Biri, leu si një fëmijë i vogël nga mishët e Adhamit e ë dhënë të besmëvet. Të jetës s'jardhshiht Ati e Krietari e thritet Ëngjëlli i të Madhit Këshill.

Ki isht Perëndia i fukjishëm e me pushtet zotëron kriesën.

2. Si rrrij Jona në fund të dejtit Të parkalesi t'veje e t'sosie furturën. U i varruar nga shigjetat e atij çë më tiranisë të parkales, o Krisht, Tij çë liron nga të kekjat, sa t'i dalsh përtimit t'im përpara .

-Aì çë më para ishë me Perëndin e Aì vet Perëndi Fiala, posa sheh se natura jonë ngë kle e mirë të ruhej, nanë e fortson tue jar-dhur në një bashkim të ri çë bën atë përsëri e lirë nga epshet.

-Nga ija e Abramit del pér ne sa tē ngrënje bijtë të rarë mjerisht te errësira e mëkatëvet çë i uji posht Aì çë bujton Dritën e nanë pa të drejt pranon grazhdin pér shëndetën e njerëzëvet .

K o n d a k j i i

Virgjëresha sot të përbiklënëshmin lind e dheu shpellën të paarrënëshmit dhuron; Ëngjëjit me delmerët lavdërojën Magjinjtë pra bashkë me illin udhëtojën; se pér ne jerdhi e lindi si Dialë i ri i paramotshmi Perëndi .

O O I K O S

Sot Vithleémi sbill Edherin:na gjejöm harén nē tē fshehtitö : ejani tē trazhgojäm Parraisin te këjo shpellë. Ati u dëftua rrenja e pa potisurë, çë lulëzon ndëjesën: ati u gjënd putsi çë mosnjera dorë grëmoi tek i çili Davidhi dishiroi tē pij: ati Virgjëra tue lindur Dialin shuajti etën e Adhamit e tē Davidhit.

Prandai rrriedhiëm shpejt ku leu Diali i ri , i pazëni Perëndi .

s i n a k s a r i o n :

t e d i t a n jëz e t e p e s e t e këtij moi : TË LERIT NË KURM E ZOTIT T'ËNË PERËND= E SHPËTUES IISU' KRISHTI .

s t i h j i : Aì çë lehet ë Perëndia. E Jëma isht Virgjërë. Çë pa kurr më tē bukur e më tē mathë Kriesa ? Virgjëra Marie lind Perëndin tek e njëzetepesta ditë.

Tek e njëjta ditë përmendiëm TË PËRMISURIT E MAGJINJËVET.

Tue u përmisur Tij Magjintë, Fialë, gjindarët tē dëftojën nderrinçë ka t't'bëjën kombet.

Kujtojëm edhe sot DELMERËT çë rrodhën tē gëzoneshën tek i nö Zot.

Delmerët lan grigjet e 'tire e rrodhën sa t'shihiën Delmerin i mirë , Krishtin .

ATIJ LËVDI' PËR JETË TË JETËVET

A M I N .

ODHA E SHTATËTË

Djemtë të rriturë në lutësi përbuzën urdhurimin të palutshëm e ngë u trëmbën kanosies e ziarrit, po në mes t'flakës rrrijën tue msalur : O Perëndi i atëravet t'anë , Ti je bekuar !

Delmerët çë ruajën grigjet patën fatin e njëi pamie e ndritshme çë i trëmbi: ishë lëvdia e t'in'Zoti çë i ëmbarisi e Engjëlli çë thërrisëj: këndoni pse leu Krishti!

O Perëndi i atëravet t'anë, Ti je bekuar !

Njëiherie me fialën e Engjëllit ushtrit e kjielliavet uluritën: lëvdi Perëndis te më i larti kjiell , pakje mbi dhet , mirëdashie ndër njerëzit : Krishti u dëftua!

C Perëndi i atërevat t'anë , Ti je bekuar!

Çë janë këto fialë ? thanë delmerët . Vemi e shohiën çë kle . Isht Krishti Perëndi! E si arrun në Vithleém, ju përmisën bashkë me të Jëmën tue kënduar: O Perëndi i atëravet t'anë, Ti je bekuar!

2. Të marrë nga malli i Rregjit i gjithësis gjemtë në vargje përbuziën të folët të palutshëm të mbretit i egërsuar e si i pathënëshmi ziarr largonet nga ata,i thonë t'in'Zoti: për gjithëmonë Ti je i bekuam.

Shërbëtorët i djek me vrull, po kursën gjemtë flaka çë buron me zhurmë te furri i ngrohur shtatë herë më shumë se zakona:pse paj të lutësis s'tire in'Zot , këtireve çë flaka ka kjarkuar , i dërgon e buruame vesën .

O Krisht mbrojtës , shnderove armikun e njerëzëvet nani çë morre, me viershë i pathënëshëm, mi shët njeriu si mburonjë e në këtë trajte i prure dhuretin e hynizimit me shpresën e t'çilit kemmi rar te honet të errtë.

Isht mëkata e rreptë krenie të pambajturë e njëi jetie e tërbuame çë kremton të padëlira çë Ti, o Krisht, prish me gjithë pushtetin t'ënd e ata çë më para helkje tek Ti nga kurthet e 'tire i shpëton sot çë deshe, o Mirëbërës, të bëneshe njeri .

ODHA E TETËTË

Furri çë buron vesë isht fitire e tipi e njëi famasmie e mbinaturshme. Ngë djek djemtë çë pati hijturë brënda si as ziarri i Hjynis ngë prish gjirin e Virgjérës ku

Ajo hin. Andai tue himnuar këndo jëm: gjithë kriesa le t'bekonjë t'ën'Zonë dhe të lartësonjë Atë për gjithë monë .

E Bija e Babilonës ndsori jashta Sionit me fukjìn e shpatës të bijët e Davidhit. Nani dërgon Magjinjtë bij të 'saj me dhurata sa t'i falen të Bijës s'Davidhit , putçer i t'in' Zoti .

Andai tue himnuar këndo jëm: Le të bekonjë gjithë kriesa t'ën'Zonë dhe të lartësonjë Atë për gjithë monë.

Lipi veglet musikore i uli posht, përsé të bijët e Israelit ngë i bien nö ~~nes~~ t'huajëvet. Po Krishti tue ler Vithleém prish gjithë gënjinin e Babilonës e përterihet armonia e muzikës. Andai tue himnuar këndo jëm: le t'bekonjë gjithë kriesa ...

Babilona mori plaçkat e Mbretëreshës SION e kjosmët me shpatën.

Krishti me një ill çë i udhëhé-kjë, rrnar në Sion thesaret e Babilonës me rregjërat veshguesë të ijëzëvet. Andai tue himnuar këndo-jëm: Le të bekonjë ...

2. Djemtë e Dhiatës e vietrë sh-turë te furri pa klënë djegur pér-fakjësojën gjirin e Virgjérës çë lindi nbi fukjìt e naturës tue mbetur e vulosurë. Isht Dhurata e hjynushme çë me një famasmë bën tö dia e ngrën popujit me gëzim të këndojën .

Tue jikur ftesën e të kërkuarit të lënë të bënej Perëndi, nani gjithë kriesa me Djentë këndon me dre:të pérhershmen Fialë çë pérunjet.

Ajo trëmbej të falëj një lutie e papëlkjieshme pse ishë e prishë-shme edhë në Dieja e mbante në të klénit.

Ti vien të prierësh naturën e sbierrë e njerëzëvet në kulotë e lulëzuame nga kodhra të shkreta, o Ngjallia e kombëvet !

Shuaj fukjin e tmerrshme e vra-sorit Ti çë me parakujdesin t'ent u dëftove Perëndi e Njeri .

ODHA E NËNDËTË

Madhërimet

Madhërò, o shpirti i jim, më të nderoshmen e më të lëvdoshmen ndër gjithë fukjit e kjielliës .

Madhërò, o shpirti i jim, Perëndin çë lehet si njeri nga Virgjëra.

Madhërò, o shpirti i jim, të madhin rrekjë çë leu te një shpellë.

Madhérò,o shpirti i jim,t'madhin
Perëndì nga Magjintë i proskjini-
sur.

Madhérò,o shpirti i jim,Atë çë
nga illi Magjinjëvet ë 'ftuar.

Madhérò,o shpirti i jim,të dë-
lirën Virgjérë çë na leu Krishtin
Vasilé.

Magjinjë e delmerë erdhën t'pro-
skjinisiën Krishtin në Vithleém.

Sot Virgjëra lind t'ën'Zonë
brënda te një shpellë.

Sot Zoti i Mathë lehet si Dialë
nga një Mëmë Virgjérë.

Sot Delmerët shohiën Shpëtuesin
pështiellë me skutina i vënë në
grazhd.

Sot gjithëjeta bën haré e gjëzim

se Krishti na u le nga një vajzë
Virgjérë.

Fukjìt kjellore Shelbuesin të
ler,të madhin Zot jetës lajmëro-
jën.

Madhérò,o shpirti jim,fukjin e
Hjynis e trivetshme dhe e pandar-
shme

Madhérò,o shpirti i jim, Virgjë-
rën çë na liroi nga nëma e mot-
çme .

Mister tē mathë u shoh e tē humbët :

pér kjiell shpellën;
 pér thronmdér Hjeruvimtē Virgjëreshën ;
 grazhdin pér vend teku kle ngulur i pasosmi Krisht Perëndia ;
 t'çilin tue kënduar madhérojém na.

Si pan Magjinjtë dhromin tē veçant tē ndritur e njëi illi i ri, jashtzakonshme dritëri e çë shkëlkjente, ndëlguan se kishë ler Krishti rrekjë në Withleém pér shëndetën t'ënë.

Ku isht Diali i ri rrekjë e tē çilit na pam illin? thoshëjën Magjintë, pse na erdhëm t'i përmiseshëm Atij. U tërbua Erodhi, i dolën trut. Armiku i t'in'Zoti ku-

.....

dsoi tē ndsirëj ngrahëshit Krishtin.

Vëshgoi Erodhi kjeroïn e illit nga i çili Magjinjtë tē përsiel-lurë në Withleém u përmisën Krishtit me dhuretít e 'tire.

E nga ai tē udhëhekjurë në Athdé lanë tē perkjesur tē tmer-rshmin vrqasor tē fëmijës.

2. Pér ne isht më lehtë tē kë-nakjemi tē rrim pa folë në dre, pse pa rrëzik, o Virgjérë, përgë vështirë isht tē endiën me mall himne tē mprehurë me armoni. Po Ti, o Mëme, ëna fukjì akjë sa na buroi dëshiri .

Na çë pam tipet t'padritë e hjet çë largojën nga Fiala, o Mëmë e dëlirë, nani çë i Vogëli dëftonet tue dalë nga dera e mbëlli-me e jemi gjikuar tē mirë pér

dritën e tē Vërtetës , tē bekōjäm gjirin si tē nget.

Populli Krishtdashës, posa i u vërtetua dëshiri, e kle bër i mire për pranin e Perëndis, nani lutet për rilindien ç'isht gjellëdhënëse. O Virgjérë e papërlieme, ëna hirin tē proskjinisiëm Lëvdin.

e k s a p o s t i l a r i i

Mbi ne prori sit
nga t'lartit Shelbuesi jinë ;
Lindia e lindiëvet
e na çë ishëm në tē erröt e në
 hjé
gjetëm tē vërtetën
se nga Virgjëresha leu i Madh'
 in'Zot.

L e v d i t

Çëdd frimë lëvdoft t'en'Zonë

Lëvdoni t'en'Zonë nö tē lartitë;
se Tij tē ka hjé çëdò lëvdì , o
Perëndi!

Gëzonij , o ju tē drojtë; ju kji-
ellia bëni haré; ju male kërtseni
se Krishti u le. Virgjëresha rri
ujurë tue i glar Hjeruvimëvet e
mban n'krahë Perëndin Fialë bër
njeri. Delmerët lëvdojën tē Lerin
Dialë; Magjinjtë tē Madhit Zot i
bien dhurata ; Ëngjëjitë tue kën-
duar po thonë: O Zot i pa-kapshëm,
lëvdì Tij .

Lëvdoni Atë o ju gjithë ëngjë-
jitë e 'tij , lëvdonie ju gji-
thë fukjit e 'tija.

Atit i pëlkleu e Fiala u bë mi-
shë e Virgjëresha lindi Perën-

dìn i bër njeri. Illi prin , Magjinjtë proskjinisiën , delmerët po famasen e jeta bën haré.

Lëvdoni Atë , o ju ijze e drिते; lëvdonie o ti diell e ti hën-zë .

Virgjëresha e Mëma e t'in'Zoti , çë si na linde Shpëtuesin na ndsore nëmën e Evës , se u bëre Mëmë të mirëdashies t'Atit tue siellë në gji Perëndin Fialë të njerë - zuar. Ki mistér s'duron sbulesë; vetëm me besë na e lëvdojëm tue thirrur me Tij e tue thënë: i pa-ndëlgashmi Zot , paçe lëvdì!

Lëvdoni Atë , o ji gjithë popuj, o ju rregjëra, krieta- rë e gjikëtarë të jetës.

Ejani të këndojojëm Mëmën e Shpë- tuesit çë pas çë lindi , përsëri u 'ftua virgjërë. T'falemi, o kji- tet shpirtulor të rregjit e Perën- dis teku Krishti tue jesur na ve- proi shëndetën. Bashkë me Gavri- lin të lartësojëm , bashkë me del- merët të lëvdojëm.

O Mëma e t'in'Zoti , lus Ti Atë çë u mishërua tek Ti të na shpë- tonjë.

Lëvdi past ...

Si erdhi koha e të jardhurit t'ënt në dhe, i pari njehsim u bë në jetë. Atë herë deshe të shkru- heshën embret e atireve çë beso- jën te të lerit t'atë. Prandai kle shpallur ki urdhurim i Kje- sarit dhe e pasosmia mbretëri jo- te e pa fillim zuri pameta.

Andai tē faliëm edhe na, nē vend
tē haromavet e gjobës, dhuratën e
Besës e tē t'prëmisurit t'anë Tij,
o Perëndi e Shpëtues i shpirtra-
vet t'anë.

nani e ...

Sot Krishti lehet nē Vithleém
nga Virgjëra. Sot zë fill Aì çë
s'ka fillim e Fiala mishöronet.

Gëzonen fukjit e kjielliös e
Dheu me njerëzit bën haré. Del-
merët shpalliën çudhin e 'tire e
na pa pushuar këndojojm: lëvdì te
m'i larti kjiell, pakjie mbi dho
e mirëdashie ndër njerëzitë.

te Mesha

Antif. 1. Dua tē t'lëvdonj, o
i Madh'in'Zot, me gjithë zëm-
brën t'ime; dua tē rrefienj tē
gjitha famasmët t'ote.

Ant. 2. Il lum njeriu çë i
trëmbet t'in'Zoti e çë i ka ënda
shumë nē urdhurimet e 'Tij.

Na shpëtò, o i Biri i
Perëndis çë leve nga Virgjëra
neve çë tē msaliëm aliluja.

Ant. 3 Zoti i tha t'im Zoti : uju
tek e drejta jime njer çë tē vë
armikjët t'atë nën këmbëvet t'ote.

Të Lerit t'atë... f. 77.

*në vend të Ejani t'i falemi ...
Nga gjiri i jim më para se
illi i menatës U të leva.*

Bëri be in'Zot e ngë peno-
nëtë: Ti je prift përgji-
thë monë i rradhës s'Mel-
kjisedekut . Na shpëtò ...

A p o l i t i k j i f.77

Kondakjii f. 99

në vend të Trisajit:

O sa në Krisht u pagëzuat,
me Krishtin ju u veshët.
A l i l u j a .

në vend t' "Aksionestinit:

Madhërò, o shpirti i jim , më të
nderoshmen e më të lëvdoshmen ndër
gjithë ushtrit e kjiellit.

Mister të mathë ... f. 110.

k j i n o n i k o i :

Shpëtim i dërgoi in'Zot popullit
t'tij, aliluja.

në vend të Bekuar kloft embri,..

Shi' lehet Krishti , lëvdonie...
f. 85.

D e f t u e s i

1. Kur te jeta in'Zot u le f.3.
2. Te këjo herë kush ngë kla 4.
3. Punë e madhe isht këjò f.6
4. Zonja e jime mirë ditë f.9.
5. Zonja e lume e shë Mëri f.13.
6. Shë Mëria tue kënduar f.19
7. Kur shë Mëria f.22
8. Kur dimbri ishë i kekjë. f.28
9. Ahierna kur in'Zot ... f.121.
10. Një ditë u vet llojasia f.30
11. Gjithë ejani gjinde f.33
12. Nga kjielli ti u sdripe f.36
13. Këndo jëm, këndo jëm... f.40
14. Rregji i jim F.41
15. Flëjëmë bukur dial... f.44
16. O çë natë n'e bukurë... f.46
17. E fiellët isht nata... f.48
18. Rroft, po rroft... f.49
19. Si gjegjën ëngjëjit f.51
20. Të falem, o i lëvdoshmi f.52

Ahierna kur in'Zot u le te jeta
 ish'natë e dukej si kur t'ishë
 mjesdita;
 se të përzurë
 e të dhevurë
 kurr u dukën ijt ashtu'.
 Ndë Lindie shkoi
 e tre magjinjë nga ata më i miri
 'ftoi.

Ngë ndodheshën armikje aherë
 te dheu;
 tue bredhur bashkë me viçin rrrij
 ariu;

te pylli i vrërët,
 bashkë me drerët,
 bisha rroj me pakje e gas;
 edhe i sbutsuar,
 u pa me kjenkjin ulku mbë të fuar.

Barinjëvet ç'ishnë e ruaiën
 dhent te mali,
 tue shkrepur dritë të madhe,

nj'ëngjëh foli;
të lum ndër t'jerë,
o delmerë,
të mos kini frikë , i tha ,
gëzim e haré,
se sonte një parrais u bë ki dhe.

*në vend të luties 'opistamvonë'
e përditshme :*

O Krisht Perëndia jinë, çë më
para se gjithë jetët ke klënë i
lum nö gji të pazënët At e çë te
të sprasmitë kjeronje, paj të Vir-
gjérës s'Shejte u mishërove e le-
ve ndër ne ; Ti çë u bëre i vapëk
sa na të kjoseshëm paj të vapkë-
sës t'ënde; Ti çë si fëmijë u pë-
shtolle me skutina e kleve ngulur,
Ti Perëndì, te një grazhd , o i Ma-
dh'in'Zot çë ke kujdesin e gjithë-
sës, prit mirë këto të pavëjefshme

lutie t'ona e lëvdì si prite mirë
lëvdit e delmerëvet e dhuretìt e
të përmisurit e Magjinjëvet.

Tue na ndëjér çëdò mëkatë bën-
na të trazhgojën harén e kjielliës
e përgatiturë atireve çë kretnojën
mirë të Lerit t'at , përqë Ti je
Mik i njerëzëvet e i lëvduam me
të pazënët At e me gjithështetin
e i mirë e gjellëdhënësin Shpirt
nani e gjithë monë e për jetë të
jetëvet. Ashtu' kloft.

LIKJÉRATË tē Shën Janit Gojart
Oh çë sherbés i mathë e jashtza-
konëshëm shoh u sot!

Te veshët më kumbon këndimi i delmerëvet. Ngë isht një këndim pérjashtie, po një zë kjiellie. Edhé ëngjëjité këndo jën; bëjën gëzim arkëngjëjité; imnojën Hjerruvimtë; lavdërojën Serafimtë.

Gjithë bëjën haré tue par Perëndin mbi dhet e njeriun në kjieh.

Betlemi sot isht nj'atrë kjieh teku Ëngjëjité tue bër festë rrin në vend tē ijëzëvet, teku i pasosmi diell i drejtësis pështron diellin e mjesditës.

Sot Aì çë isht i paramotshëm lehet nga një Virgjérë te vapkësia e Betlemit. Këtu' vijën e

, bien përmist rregjërat sa t'proskjinisiën tē kjiellshim Rrekjë tē lëvdis; ushtarët tē Parin e ushtrivet; grat Atë çë u le nga një grua sa tē ndërroj më gëzim dhëmbiet e gruas; virgjërat proskjinisiën tē Birin e Virgjëreshës; fëmija Atë çë jerdhi në jetë si fëmijë e djelmtë tē paftesë Atë çë ndër 'ta kle si e para lule e Martravet; tē mëdhenjtë proskjinisiën Perëndin çë u bë njeri; delmerët Delmerin e mirë çë jep gjellën e 'tij pér delezit e 'tija; priftrat tē Parin e priftravet, shërbëtorët Atë çë u bë shërbëtar pér ne. Gjithë tē mëkatruamitë, gra e burra, proskjinisiëm Kjenkjin çë ndsier mëkatët e jetës.

Të gjithë anadi në dhe e në
kjieh bëjëm gëzim e haré!

E me gjithë vuhem edhé U, jo me
lodra e haliasisa e dëfrime, po
tue marrë n'krahë ato skutina
tëbekuame teku kle pështuellë
in'Zot fëmijë në djebë. Këto ja-
në shpresë jime, këto janë
për mua dëfrimet e harët; këto
janë çë më bëjën të këndonj edhé
U bashkë me Ëngjëjitë: Lëvdì Pe-
rëndis në më të lartitë e kjie-
lliavet, pakje në Dhe e njerë-
zëvet vullnesë e mirë.

*(Ki përkthim kle gjetur ndër
dorëshkrimet e të ndjenit Pas
pa Sepë Petta)*